

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MARRËDHËNIET E
AVOKATURËS SË SHETIT DHE PERSONAVE JURIDIKË NË KUADËR
TË OFRIMIT TË ASISTENCËS JURIDIKE, ROLIN E AVOKATËVE TË
SHETIT NË GJYKIM, SI DHE NORMA TË POSAÇME
PROCEDURALE”

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN**

Objektivat që synohen të arrihen me miratimin e këtij projektvendimi, është përcaktimi në mënyrë të plotë i rregullave dhe procedurave për marrëdhëniet midis Avokaturës së Shtetit dhe personave juridikë, në kuadër të ofrimit të asistencës juridike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe norma të posaçme procedurale, për mënyrën e ndërveprimit dhe bashkëpunimit me institucionet shtetërore. Ky projektvendim do të plotësojë kuadrin ligjor të veprimtarisë së Avokaturës së Shtetit në dhënien e asistencës juridike, mënyrën e bashkëveprimit të punës me institucionet shtetërore, dhe do të përmirësojë cilësinë dhe efikasitetin në kryerjen e kësaj veprimtarie. Ky projektvendim vjen në harmoni me objektivat e ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, të ndryshuar, duke synuar fuqizimin e rolit të Avokaturës së Shtetit në përfaqësimin e interesave pasurore të shtetit, nëpërmjet ekskluzivitetit të dhënies së asistencës juridike.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektvendimi nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave, për vitin 2023. Projektvendimi vjen si nevojë e plotësimit të kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit nr.10018/2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar. Ky akt është hartuar në përputhje me programin e qeverisë, duke përcaktuar në mënyrë të detajuar procedurat e ofrimit të asistencës juridike, në funksion të mbrojtjes dhe përfaqësimit të interesave pasurore të shtetit sa më me efektivitet dhe në përputhje me normat ligjore në fuqi.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i këtij projektakti paraqet rëndësi të veçantë, qoftë për Avokaturën e Shtetit, qoftë për personat juridikë publikë apo me kapital shtetëror, pasi ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e ofrimit të asistencës juridike, nëpërmjet:

1. Saktësimin të mënyrës dhe procedurave të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe Avokaturës së Shtetit me qëllim realizimin e mbrojtjes dhe përfaqësimit cilësor dhe efektiv.
2. Zgjidhjes së problematikave që dalin gjatë procesit të përfaqësimit dhe që ndikojnë në dhënien e asistencës ligjore, nëpërmjet parashikimeve dhe procedurave konkrete.
3. Parashikimit të kërkesave procedurale dhe veprimeve që duhen ndërmarrë në rastet e dhënies së asistencës juridike.
4. Fuqizimit të rolit të Avokaturës së Shtetit për përfaqësimin e interesave pasurore të shtetit, duke parashikuar dispozita lidhur me forcimin e asistencës së Avokaturës së Shtetit për personat juridikë.

Nëpërmjet këtij projektvendimi, sqarohen në mënyrë shteruese hapat dhe veprimet që duhen ndërmarrë në rastet e përfaqësimit ligjor apo këshillimit, për të garantuar një proces të rregullt, në përputhje me normat ligjore në fuqi, dhe për t'i ardhur në ndihmë të gjithë procesit të përfaqësimit dhe mbrojtjes nga Avokatura e Shtetit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është në përputhje me Kushtetutën, me legjislacionin material e procedural civil dhe administrativ të Republikës së Shqipërisë, dhe ligjin nr.10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar.

Përmbajtja e këtij projektakti nuk tejkalon kompetencën që i është akorduar Këshillit të Ministrave nga dispozita e mësipërme ligjore.

Për sa i përket çështjes së kushtetutshmërisë së projektvendimit, nga pikëpamja formale, ai përbën një akt nënligjor të nxjerrë në respektim të tre kritereve të parashikuara nga neni 118 i Kushtetutës.

Në lidhje me kushtetutshmërinë në këndvështrimin lëndor/thelbësor, vlerësojmë se, projektakti u përmbahet standardeve kushtetuese.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektakti nuk synon përafrim me *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi i paraqitur për shqyrtim është i strukturuar në shtatë krerë dhe 36 nene.

Ky projektvendim shfuqizon vendimin nr. 392, datë 8.4.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale”, i cili është aktualisht në fuqi, dhe një pjesë e dispozitave ekzistuese integrohen njësoj në projektakt, pa i ndryshuar kuptimi dhe qëllimi.

Në kreun I, parashikohen dispozitat e përgjithshme që kanë të bëjnë me:

Objektin e kësaj rregulloreje, që është përcaktimi i rregullave për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me personat juridikë, rastet dhe çështjet e ushtrimit të

funksionit të përfaqësimit dhe mbrojtjes në gjyq, rastet dhe çështjet e ushtrimit të funksionit të këshillimit, mënyrën e bashkërendimit të punës së avokatëve të shtetit me personat juridikë, marrëdhënien e bashkëpunimit me institucionet të cilët detyrohen t'i vijnë në ndihmë avokatit të shtetit në kuadër të ofrimit të asistencës juridike, dhe çështjet ekonomike dhe shpenzimet e procesit.

Në nenin 5, të projektregullores janë përmirësuar dhe qartësuar disa të drejta dhe detyrime, të strukturave përgjegjëse për të bashkëpunuar me Avokaturën e Shtetit gjatë përfaqësimit dhe mbrojtjes në çështje gjyqësore, duke përfshirë edhe një person kontakti (koordinator), me qëllim shkurtimin e kohës së ndërveprimit dhe plotësimin me fleksibilitet dhe saktësi të kërkesave rast pas rasti. Duke mbajtur në konsideratë dinamikën dhe afatet e ngutshme për sigurimin e provave apo kërkesave të tjera që lindin gjatë zhvillimit të proceseve gjyqësore, çmohet i domosdoshëm krijimi i një mekanizmi efikas, nëpërmjet të cilit të arrihet përgatitja në kohë e çdo akti që shërben për realizimin e mbrojtjes efektive në gjykim. Personi i kontaktit do të luajë një rol të rëndësishëm në procesin e bashkëpunimit institucional dhe të shkëmbimit të informacionit, duke bërë shpërndarjen sipas rolit dhe kompetencës të çdo kërkesë që i paraqitet nga Avokatura e Shtetit, dhe duke garantuar përmbushjen dhe kthimin e përgjigjes në kohë dhe me efikasitet.

Në kreun II, parashikohen rregullat lidhur me:

- Rastet dhe çështjet e ushtrimit të funksionit të përfaqësimit dhe të mbrojtjes në gjyq nga Avokatura e Shtetit, të cilat renditen në harmoni me përcaktimet në ligj;
- Procedurën e përfaqësimit;
- Kriteret lëndore dhe sasore për delegimin e të drejtës së përfaqësimit dhe të mbrojtjes;
- Delegimin e përfaqësimit dhe të mbrojtjes te personi juridik i interesuar dhe detyrimin për pranimin e delegimit;
- Detyrimin për bashkimin e qëndrimit në përfaqësimin ligjor të personave juridikë. Në këtë dispozitë është parashikuar se personat juridikë kanë detyrimin t'i njoftojnë Avokaturës së Shtetit qëndrimin e tyre me shkrim, dhe kjo e fundit ka ekskluzivitetin për të vendosur mbi strategjinë e përfaqësimit dhe të mbrojtjes. Në praktikë është evidentuar se në disa raste përfaqësuesit e personave juridikë

kanë shprehur qëndrime jo të ngjashme me Avokaturën e Shtetit, si dhe nuk janë konsultuar më parë me avokatin e shtetit për strategjinë e përfaqësimit dhe të mbrojtjes. Një praktikë e tillë cenon cilësinë e mbrojtjes së interesave pasurore të shtetit në procese gjyqësore, si dhe vjen në kundërshtim me dispozitën 1/1, të pikës 5 të ligjit nr. 100018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar. Për këtë arsye është parashikuar se juristët që përfaqësojnë personat juridikë duhet të njoftojnë qëndrimin e tyre avokatit të shtetit përkatës, i cili në përfundim vendos mbi strategjinë e mbrojtjes, si subjekti që gëzon ekskluzivitetin e dhënies së asistencës juridike;

- Përfaqësimin nga Avokatura e Shtetit, sipas ndarjes së zyrave përkatësisht për gjykatat kombëtare dhe të huaja;
- Përfaqësimin në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit. Në këto dispozita parashikohet mënyra e bashkërendimit të punës ndërmjet personit juridik dhe Avokaturës së Shtetit gjatë përfaqësimit në gjykim, si dhe tagrat e përfaqësimit që gëzon Avokatura e Shtetit;
- Përgatitjen dhe depozitimin e rekursit, duke përcaktuar veprimet dhe hapat që duhen ndërmarrë nga personi juridik në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit, për përgatitjen dhe depozitimin e rekursit, duke përfshirë edhe çështjet gjyqësore në të cilat Avokatura e Shtetit ka deleguar të drejtën e përfaqësimit dhe të mbrojtjes;
- Përfaqësimin në Gjykatën e Lartë, hapat që duhen ndërmarrë nga personi juridik në momentin që merr njoftim për shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë. Në këtë dispozitë janë përshtatur hapa procedurale në përputhje me ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile;
- Përgatitjen dhe depozitimin e ankimit kushtetues individual, veprimet dhe autorizimet që duhen dhënë kur vlerësohet se duhet paraqitur ankim;
- Rolin e avokatit të shtetit në gjykim dhe marrëdhënien me personin juridik.

Në kreun III, parashikohen rregullat lidhur me nismën për fillimin e procedurave administrative dhe ligjore, veprimet që duhen ndërmarrë dhe autorizimet e nevojshme për përfaqësim dhe rregullat lidhur me marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me personat juridikë në kuadër të këshillimit.

- **Neni 19** përcakton rastet e ushtrimit të funksioneve këshillimore nga Avokatura e Shtetit, për të kërkuar mendim me shkrim, për çështje të karakterit juridik, të

cilat mund të prodhojnë pasoja financiare për shtetin, në përputhje me nenin 15 të ligjit nr.10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", i ndryshuar, mendim për projektkontrata, të cilat do të nënshkruhen prej tyre, duke sugjeruar paraprakisht përmbajtjen e tyre. Në dy pikat e fundit, të nenit 19, parashikohen rastet kur këshillimi paraprak i organit përkatës të administratës publike me Avokaturën e Shtetit është i detyrueshëm për t'u kërkuar duke parashikuar katër raste konkrete kur ky këshillim është i detyruar, rastet të cilat janë parashikuar të tilla në mbështetje të ndryshimeve ligjore të vitit 2018, të ligjit nr.10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit" dhe karakter jo detyrues i këshillimit, përveç rasteve kur parashikohet si i tillë me ligj.

Në nenin 20 parashikohen dy kategoritë e personave juridikë të cilët mund t'i drejtohen Avokaturës së Shtetit, me kërkesë për këshillim, më konkretisht personat juridikë sipas kuptimit të ligjit nr.10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", i ndryshuar të parashikuar në nenin 5, pika 1/1 të ligjit dhe organet e njësisive të vetëqeverisjes vendore, të cilat kanë marrëveshje të posaçme me Avokaturën e Shtetit, dhe që i drejtohen kësaj të fundit me kërkesë për këshillim nëpërmjet kryetarit të tyre.

Në nenin 21 të kësaj projektregulloreje, parashikohet procedura e këshillimit dhe mënyra e paraqitjes së një kërkesë për këshillim. Procedura e këshillimit është parashikuar në mënyrë të detajuar marrë shkak nga problematikat që Avokatura e Shtetit ka hasur në praktikë me paraqitjen e kërkesave për mendim këshillimor nga persona juridikë të ndryshëm të pashoqëruara me dokumentacion plotë dhe shterues, pa një pasqyrim të plotë të rrethanave dhe problematikës së praktikës në fjalë dhe pa e shoqëruar çështjen/mosmarrëveshjen/praktikën me një vlerësim të plotë nga ana e vetë personit juridik. Vënia në dispozicion e këtyre dokumenteve është parashikuar në paragrafin 1 të nenit 21 së bashku me plotësimin e të dhënave të kontaktit të personit juridik që kërkon këshillim, informacion që paraqet rëndësi, pasi krijon mundësi komunikimi të vazhdueshme midis Zyrës së Këshillimit dhe personit juridik, për çdo kërkesë dhe të dhëna plotësuese që mund të kërkojnë gjatë procesit të këshillimit. Gjithashtu, parashikon kërkesën e Avokaturës së Shtetit për të kërkuar informacione të tjera plotësuese kur e vlerëson të nevojshme dhe detyrimin e personit juridik/ organit të njësisive të vetëqeverisjes vendore për plotësim brenda 5 ditëve nga depozitimi

i kërkesës së Avokaturës për plotësim. Kjo dispozitë vlerësohet të parashikohet duke përmirësuar kuadrin ligjor për shkak të problematikave të hasura më herët si rrjedhojë e mungesës së dokumentacionit të plotë dhe zvarritjes së dorëzimit të dokumentacionit në kohë nga personat juridikë, duke e vështirësuar punën e Zyrës së Këshillimit për të dhënë një këshillim të bazuar në një analizë të mirëfilltë juridike, mbështetur në një dokumentacion të plotë. Mendimi këshillimor është konfidencial, është pjesë e praktikës së këshillimit dhe jepet gjithmonë me shkrim.

Neni 22 parashikon se shërbimin këshillimor jepet me shkrim në mbrojtje të të drejtave dhe të interesave pasurorë të shtetit, duke u bazuar në një analizë të mirëfilltë juridike të çështjes objekt këshillimi. Në asnjë rast, këshillimi nuk mund të jetë vlerësim mbi qëllimin e nxjerrjes së aktit juridik. Nevoja për këtë nen ka ardhur pasi mendimi këshillimor i dhënë nga ana e Avokaturës së Shtetit të mos përdorej nga personat juridikë me qëllim për të nxjerrë akte juridike duke u mbështetur në këtë mendim të dhënë. Avokatura e Shtetit mund të sugjerojë edhe formulime konkrete të pjesëve të veçanta të kontratës. Ky sugjerim ka ardhur pasi Avokatura ka qenë dhe është pjesë e grupeve negociatore të punës dhe si e tillë ka dhënë kontributin e saj në hartime dhe në formulime për nene të caktuara të projekt-kontratave.

Së fundmi neni 22 parashikon rastet kur Avokati i Përgjithshëm vlerëson rast pas rasti, kërkesën e personit juridik për pjesëmarrjen në negociimet e kontratave (nënshkrim, ndryshim dhe zgjidhjen e tyre). Ky parashikim bëhet me qëllim që vlerësimi i pjesëmarrjes apo jo në negociata të avokatëve të shtetit të jetë në diskrecion të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit duke pasur parasysh ngarkesën e Zyrës së Këshillimit, fazën në të cilën po kërkohet këshillimi dhe lloji i objektit për të cilin kërkohet këshillimi

Gjithashtu, duke qenë se në praktikë ka pasur problematika lidhur me paqartësinë e rolit të avokatit të shtetit në negociata, ka lindur nevoja që të parashikohet në mënyrë të qartë në çfarë cilësie ndodhet avokati i shtetit në negociata, atë të konsulentit (kur kërkohet nga personat juridikë) apo të anëtarit të grupit të punës me të drejte vote/firme (kur emërohet nga Kryeministri). Prandaj, është

parashikuar që gjatë proceseve të negocimit të kontratave, Avokatura e Shtetit merr rolin e konsulentit të personit juridik dhe jo të anëtarit të grupit të punës, kjo për të bërë dallimin në rastet kur ajo është anëtare e grupit të negocimit si konsulent dhe të rasteve kur merr pjesë në grupe negociatore të ngritura me urdhër të Kryeministrit si anëtar i grupit të punës për negocimin e kontratës. Pika e fundit e nenit 22 parashikon se këshillimin i dhënë nga ana e Avokatura e Shtetit konsiston, kryesisht për të vënë në lëvizje, të kundërshtuar ose për të tërhequr një çështje në gjykim. Ky mendim mund të jetë edhe sugjerim për procedimet administrative, me natyrë konfliktuale, ky nen është parashikuar për të pasqyruar dhe saktësuar detyrat funksionale të avokaturës për të cilat ajo jep mendim dhe këshillim brenda fushës së përgjegjësisë së saj.

Në **nenin 23** jepen efektet dhe pasojat që sjell mendimi këshillimor nga ana e Avokaturës së Shtetit për personin juridik dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, i cili nuk ka karakter detyrues parashikim i cili është i shprehur qartë edhe në ligjin nr.10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, i drejtohet ekskluzivisht personit juridik, dhe në asnjë rast nuk mund të përdoret si provë në gjykim, ky parashikim për të sqaruar dhe për të bërë të qartë subjektit të interesuar që mendimi dhënë nuk mund të përdoret në gjykatë si provë. Pika e tretë e nenit 23 parashikon se pavarësisht karakterit jodetyrues të mendimit të Avokaturës së Shtetit, personit juridik/organet e njërive të vetëqeverisjes vendore, duhet të motivojë në një akt të shkruar veprimin ndryshe nga mendimi këshillimor i Avokaturës së Shtetit, i cili bëhet pjesë e praktikës përkatëse objekt këshillimi. Ky parashikim ka ardhur si nevojë e faktit se këshillimi është pjesë e praktikës së institucionit i cili e kërkon dhe veprimi ndryshe nga mendimi i dhënë duhet të argumentohet juridikisht ose teknikisht sipas rastit, për të mos dalë me dy qëndrime të ndryshme. Pika e fundit e nenit 23 parashikon se Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, me kërkesë të motivuar të avokatëve/zyrave të Avokaturës së Shtetit ose kryesisht, në varësi të kompleksitetit dhe rëndësisë së çështjeve, në bazë të praktikës së njehsuar juridike, miraton modele të përgjithshme të këshillimit për avokatët e shtetit. Ky parashikim ndihmon në ngritjen dhe konsolidimin e praktikës këshillimore të Zyrës së Këshillimit në veçanti dhe Avokaturës së Shtetit në përgjithësi.

Në kreun IV, parashikohen rregulla lidhur me:

- Marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me personat juridikë në kuadër të përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar. Neni 24 përcakton se kompetente për realizimin e përfaqësimit të personit juridik për këto raste do të jetë zyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar;
- Përfaqësimin në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar;
- Në **Seksionin 1** të këtij kreu janë parashikuar marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet përgjegjëse për ekzekutimin e masave individuale dhe të përgjithshme të kërkuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më poshtë GJEDNJ) në vendimet e saj për Shqipërinë. Ky parashikim ka ardhur si nevojë e ndryshimeve ligjore të vitit 2018, të ligjit “Për Avokaturën e Shtetit”. Në këto ndryshime ligjore, për herë të parë, u përcaktua roli koordinues i Avokaturës së Shtetit në ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
- Specifikisht, në nenin 26 të kësaj projektregulloreje, parashikohet procedura e koordinimit të institucioneve përgjegjëse, sa i takon marrjes së masave konkrete dhe hartimit të planeve të veprimit për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së, duke përcaktuar afate të qarta deri në mbylljen e procedurës së monitorimit të ekzekutimit të këtyre vendimeve nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës.
- Në **Seksionin 2**, janë parashikuar marrëdhëniet me institucionet në kuadër të bashkëpunimit për përfaqësim në arbitrazhin ndërkombëtar. Nevoja për të parashikuar në mënyrë të veçantë përfaqësimin në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar vjen si pasojë e karakteristikave të ndryshme që paraqet përfaqësimi në këto gjykata, në ndryshim nga përfaqësimi në gjykatat kombëtare por edhe përfaqësimi në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
- Konkretisht, gjykimi në arbitrazhin ndërkombëtar diferencon nga ai në gjykatat kombëtare dhe GJEDNJ, prej elementëve procedurale, kuadrit legjislativ përkatës, mënyrës së realizimit të mbrojtjes/përfaqësimit, si dhe natyrës së zhvillimit të vetë procesit.
- Në këtë seksion është parashikuar forma e ndërveprimit të personave juridikë dhe Avokaturës së Shtetit nga momenti i njoftimit të mosmarrëveshjes objekt arbitrazhi, mënyra e përcjelljes së saj prej institucionit të përfaqësuar, kërkesat paraprake të Avokaturës së Shtetit dhe detyrimet përkatëse të personit juridik,

- nevojës potenciale të grupeve të përbashkëta në përfaqësim, si dhe konfidencialitetit të komunikimit për arbitrazhet në gjykim.
- Nevoja e parashikimit të elementëve më sipër, përcaktuar konkretisht në nenet 30-33 ka ardhur si pasojë e domosdoshmërisë së sigurimit të kushteve të përfaqësimit eficient dhe substancial, i cili, në një proces arbitrazhi, është i ndërvarur nga nevoja e zotërimit të plotë të dokumentacionit dhe informacionit mbi çështjen përkatëse, si dhe nga natyra urgjente e limituese të afateve relativisht të shkurtra procedurale për të vepruar si palë.

Në kreun V, parashikohen rregullat lidhur me:

- Marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me prokurorinë, ku janë përcaktuar të njëjtat parashikime në nenin 14 të ligjit;
- Marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Praktika e Avokaturës së Shtetit gjatë përfaqësimit në çështje gjyqësore që kanë si objekt pasuritë e paluajtshme, ka identifikuar pengesë në sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm, për shkak të kërkesave për parapagim të shërbimeve nga ana e ASHK-së. Ka lindur nevoja për të ndërhyrë në projektakt, me qëllim përmirësimin dhe qartësimin e ligjit për përjashtimin e Avokaturës së Shtetit nga të gjitha tarifat e shërbimit, pavarësisht akteve nënligjore në fuqi, për shkak se kjo e fundit nuk ka të parashikuar fonde të kësaj natyre në ligjin buxhetor, sepse shërbimet e kërkuara gjithmonë janë në interes të personave juridikë. Për këtë arsye, parashikohet që tarifat e shërbimit të lëshohen në emër të personit juridik të interesuar, dhe kur nuk identifikohet një i tillë, në emër të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Vonesat që shkaktohen nga procesi i faturimit dhe likuidimit, janë një tjetër pengesë që cenon drejtpërdrejt veprimtarinë e asistencës juridike, ku shpesh herë mos regjistrimet në kohë të vendimeve gjyqësore mbi pasuritë e paluajtshme, shkaktojnë një dëm të pariparueshëm në interesat pasurorë të shtetit. Për këtë arsye, është vlerësuar i domosdoshëm përcaktimi i një mekanizmi për kryerjen në kohë të veprimeve nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, dhe në rastet e urgjencës, zbatimin me prioritet dhe në kohë të shpejtë, të kërkesave të Avokaturës së Shtetit.
- Marrëdhëniet me personat juridikë pranë të cilëve ka ekspertë me njohuri të specializuara;

Sipas raportimeve ndër vite të ecurisë së proceseve gjyqësore, është konstatuar shpesh herë mungesa e një koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet subjekteve me njohuri të specializuara, pjesë e administratës së personit juridik palë në proces, dhe avokatëve të shtetit, në kuadër të dhënies së mendimeve, qëndrimeve dhe vlerësimit të akteve, për çështje që lidhen me proceset gjyqësore. Në një numër të konsiderueshëm të rasteve, mendimi i personave me njohuri të posaçme, pjesë e administratës publike, përbën argument të domosdoshëm për ndërtimin e strategjisë së përfaqësimit dhe të mbrojtjes, dhe mungesa e këtij bashkëpunimi në kohë, ndikon negativisht në dhënien e asistencës juridike. Me anë të propozimit të kësaj dispozite, synohet që bashkëpunimi të shtrihet edhe më gjerë, në procese gjyqësore që nuk kanë palë ndërgjyqëse personin juridik në administratën e të cilit bëjnë pjesë subjekte me njohuri të posaçme.

Në kreun VI, parashikohen rregullat lidhur me:

- Në nenin 34 janë parashikuar tarifat gjyqësore, depozitat dhe garancitë. Në këtë dispozitë, ndër të tjera është parashikuar dhe nxjerrja e faturave të shërbimeve në emër të personave juridikë për interes të të cilëve Avokatura e Shtetit ka kërkuar dhënien e shërbimit, si dhe, në rastet kur nuk identifikohet një i tillë, shërbimi do të faturohet në emër të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Ky përcaktim është motivuar nga evidentimi i një sërë veprimesh administrative të domosdoshme për t'u kryer nga Avokatura e Shtetit, të cilat kanë tarifa të përcaktuara me akte ligjore dhe nënligjore, dhe që janë shpenzime që duhen shlyer nga personi juridik në interes të të cilit ushtrohet veprimtaria e dhënies së asistencës ligjore.
- Në pikën e dytë të nenit 34 është parashikuar se pagesat në lidhje me gjykimet në gjykatat e huaja, arbitrazhin vendas dhe atë ndërkombëtar, si shpenzimet gjyqësore, pagesat e arbitrave, ekspertëve të caktuar nga gjykata dhe përkthimeve, duhet të kryhen nga ana e personit juridik të interesuar ose kur palë në proces është Republika e Shqipërisë dhe nuk mund të identifikohet një person juridik i interesuar, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Nevoja e realizimit të një parashikimi të tillë vjen si pasojë e domosdoshmërisë për t'iu përgjigjur gjykatës kompetente dhe palës kundërshtare me dokumentacionin e përkthyer në kohën e duhur dhe adekuate, si dhe për të siguruar mbulimin e shpenzimeve administrative e gjyqësore të procesit brenda afateve ligjore të caktuar nga tribunali përkatës.

- Efektet ekonomike të procesit është dispozitë që integrohet sipas vendimit ekzistues.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet e ngarkuara për zbatimin e këtij projektakti, janë personat juridikë si më poshtë:

- a) institucionet shtetërore;
- b) entet publike;
- c) shoqëritë e krijuara ose që veprojnë sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, ku aksioneri shtetëror ka të drejtë të emërojë shumicën e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërisë ose zotëron më shumë se gjysmën e aksioneve apo kuotave.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga Avokatura e Shtetit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Referuar sa më sipër, projektvendimi nuk ka ndikim në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit.

PROPOZUESI
KRYEMINISTRI
EDI RAMA